



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-400/04-0230620/19, më 19-09-2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 5.1 të Rregullores nr. 01-020/01-194101/18, e dt.08.08.2018 për ndarjen e subvencioneve të komunës, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010 Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për subvencionimin e Auto Moto Karting Klubit "PRISHTINA Racing Team" nga Prishtina, në bazë të kërkesës me nr. 14-400/04-227039/19, të dt. 16.09.2019.
- II. Shuma e mjeteve financiare për subvencionimin sipas pikës I të këtij vendimi, do të jetë 500.00€ (pesëqind euro), e cila do t'i bartet në xhironlogarinë bankare me nr. 1401000013183934 në Bankën Ekonomike.
- III. Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, ndahet për mbulimin e një kostoje financiare për mbajtjen e garave automobilistike tradicionale.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
- V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa dhe dokumentacioni përcjellës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Auto Klubit "PRISHTINA Racing Team";
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

